

# KUADRI LIGJOR DHE SFIDAT PER FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL NË JURIDIKSIONIN VENDOR

RAPORT ANALIZE  
JANAR 2023



Leave  
No One  
Behind

Ky raport është përgatitur për Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” (LNB) – faza e dytë, i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Përgatitur nga: **Assoc. Prof. Dr. Nadia Rusi**  
**MBA/MPA Ilir Ciko**



**Leave  
No One  
Behind**

**United Nations Development Programme**  
**United Nations House**  
Skenderbej Street, Gurten Building, 2<sup>nd</sup> floor, Tirana, Albania  
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

# PËRMBAJTJA

1.	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E RAPORTIT	4
2.	METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT	5
3.	KUADRI LIGJOR LIDHUR ME FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL	7
4.	METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË FONDEVE PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR DHE HARTIMI I PLANEVE SOCIALE	10
5.	KUADRI LIGJOR LIDHUR ME PROKURIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR	13
6.	ANALIZË E PRAKTIKËS SË FUNKSIONIMIT TË FONDIT SOCIAL	15
	Planet sociale vendore	15
	Ngritja dhe funksionimi i Fondit Social	16
	Aspekte të programimit buxhetor	17
	Financimi nga buxheti i shtetit	19
	Vlerësime të përgjithshme	21
7.	REKOMANDIME LIDHUR ME ANALIZËN LIGJORE DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL	23

# 1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E RAPORTIT

Fondi social ka si qëllim ofrimin e mbështetjes financiare për njësitë e qeverisjes vendore për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale.<sup>1</sup> Ai krijohet dhe administrohet nga bashkitë në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale. Baza ligjore për krijimin e fondit social në nivel të qeverisjes vendore është ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Ky raport ka si qëllim analizën e kuadrit ligjor mbi të cilën bazohet funksionimi i fondit social dhe evidentimin e problematikave me të cilën janë përballur Njësitë e Qeverisjes Vendore që nga fillimi i funksionimit të fondit social. Në të njëjtën kohë, raporti ka si qëllim ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e mekanizmit të funksionimit të fondit social dhe lehtësimin e procedurave të aplikimit nga ana e bashkive me qëllim përfitimin e mbështetjes financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për të gjitha kategoritë vulnerabël.

Raporti paraqet gjetjet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të funksionimit të fondit social në nivel vendor me fokus të veçantë ngritjen dhe administrimin e fondit social nga njësitë e qeverisjes vendore. Në mënyrë të përmbledhur si objektiva të raportit mund të përmendim:

- Të analizojë kuadrin ligjor lidhur me ngritjen dhe funksionimin e fondit social dhe planeve sociale në nivel vendor;
- Të identifikojë problemet praktike të funksionimit të fondit social në nivel të qeverisjes vendore
- Të ofrojë rekomandime konkrete mbi lehtësimin e procedurave të aplikimit dhe përfitimit të mbështetjes financiare nga fondi social në nivel të bashkive

<sup>1</sup> Ligj nr. “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, Neni 47.

## 2. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Hartimi i këtij raporti është mbështetur në një kombinim të metodave cilësore dhe sasiore në terma të analizës ligjore dhe vlerësimit të funksionimit të fondit social në nivel bashkie. Me qëllim analizën e bazës ligjore mbi të cilën është ngritur dhe funksionon fondi social u studiuan:

- Ligji Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr.111/2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”
- VKM nr. 150/2019 “ Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”
- VKM nr.768/2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre.

Ndërkohë, evidentimi i problematikave praktike të funksionimit të fondit social në nivel bashkie u bazua në :

- a) Intervistat e realizuara me drejtuesit përgjegjës të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkitë e përzgjedhura
- b) Pyetësorët e strukturuar me sektorët e shërbimeve sociale në nivel bashkie.

Për të pasur një panoramë sa më të qartë dhe reale të funksionimit të fondit social në bashki të ndryshme si edhe për të evidentuar në mënyrë sa më shteruese problemet me të cilat përballen bashkitë lidhur me përfitimin nga fondi social, bashkitë e analizuar u ndanë në dy nivele kryesore:

- a) Bashki që kanë përfituar nga fondi social: Tiranë, Elbasan, Korçë, Lushnjë; Roskovec, Prrenjas, Kavajë, Rogozhinë, Maliq, Belsh dhe
- b) Bashki që nuk kanë përfituar nga fondi social: Shkodra, Kamëz, Dimal, Shijak, Pukë.

Cjithashtu, përzgjedhja e njësive të pushtetit vendor objekt u bazua edhe në disa faktorë të tjerë: numrin e popullsisë, nivelin e varfërisë si edhe shtrirjen gjeografike duke synuar një balancim të drejtë në drejtim të analizës së juridiksioneve nga të gjitha zonat gjeografike në vend.

Objekt i intervistave dhe pyetësorëve në secilin grup të bashkive kanë qënë:

- Ngritja dhe funksionimi i fondit social pranë bashkive
- Hartimi i planeve sociale vendore dhe reflektimi i nevojave të identifikuara në këto plane në kërkesat për financim nga fondi social
- Niveli i mbulimit të nevojave të evidentuara nga bashkitë përmes fondit të disbursuar nga qeverisja qendrore

- Problematikat praktike lidhur me funksionimin e fondit social
- Problematikat praktike që kanë çuar në mospërfitimin e bashkive nga fondi social.

Intervistat dhe pyetësorët e realizuar në secilën prej bashkive u shtrinë në periudhën Dhjetor –Janar.

Ndërkohë, në nivel qendror, intervistat u realizuan me përfaqësues të:

- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/
- Shërbimi Social Shtetëror

Përzgjedhja e këtyre institucioneve erdhi si pasojë e faktit se nga analiza e detyrimeve ligjore dhe strategjike, ato rezultuan si institucionet kryesore përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e funksionimit të fondit social, si edhe për udhëzimin e bashkive në terma të përfitimit nga financimi i fondit social.

Kombinimi i analizës së të dhënave sasiore dhe atyre cilësore ndihmoi në formulimin e rekomandimeve të nevojshme në drejtim të mirëfunksionimit të mekanizmit të fondit social në çdo bashki.

### 3. KUADRI LIGJOR LIDHUR ME FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL

Fillesat për nocionin e krijimit të një fondi social në ndihmë të bashkive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për kategoritë vulnerabel datojnë nga 2005. Megjithatë, vetëm në 2016, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” parashikoi në mënyrë të posaçme në Nenin 47 të tij se “Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore”. Bazuar në këtë nen, Fondi Social ka si qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja dhe zhvillimin e politikave sociale. Përcaktimi i qëllimit të Fondit Social në ligjin nr.121/2016 nënkupton dhe kufizimin e bashkive për mënyrën se si ato mund ta përdorin dhe përfitojnë prej tij. Në këtë kuptim, Bashkitë janë të detyruara që kërkesat për financim nga Fondi Social t’i bazojnë në tre drejtime kryesore:

- a) Kërkesa për financim me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror;
- b) Kërkesa për financimin e ngritjes së shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror;
- c) Kërkesa për financimin e zhvillimit të politikave sociale në nivel vendor.

Analiza në nivel të kërkesave të financuara gjatë këtyre viteve tregon se në ndryshim me dy drejtimet e para që përputhen me vizionin e Fondit Social, drejtimi i tretë lidhur me kërkesat për financim të politikave sociale në nivel vendor është formuluar në mënyrë më të gjerë, duke përmblodhur të gjitha politikat sociale në nivel vendor, edhe në rastet kur ato nuk lidhen me ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror apo përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve të shërbimeve ekzistuese. Në këtë kuptim sugjerohet rishikimi i kësaj dispozite duke e kufizuar përdorimin e fondit social në dy drejtimet e para.

Bazuar në pikën 2 të Nenit 47, Fondi social përbëhet nga:

- a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
- c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;
- ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia

Në kuptim të këtij Neni, Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon si pjesë të buxhetit të vetë vjetor fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësitë të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime të kujdesit shoqëror. Gjithashtu, Njësitë e Vetëqeverisjes Qëndrore parashikojnë në buxhetet e tyre fonde për financimin e shërbimeve ekzistuese apo për ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror si pjesë e programit buxhetor për mbështetjen e kategorive në

nevojë. Megjithatë, ajo që rezulton në praktikë është mungesa e një lidhjeje të qëndrueshme dhe koordinimi midis Fondit Social në nivel Bashkie dhe Ministrie. Në të njëjtën kohë, bazuar në nenin e sipërcituar, Bashkitë mund të financohet edhe nga organizata vendase apo të huaja për ngritjen e shërbimeve të reja apo administrimin e atyre ekzistuese. Bazuar në sa më sipër, bashkitë mund të financojnë projektet e tyre në këtë fushë njëkohësisht si nga fondet e kushtëzuara që akordohen nga Ministria që mbulon çështjet sociale ( Aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), ashtu edhe nga donatorë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë ( praktika me UNDP).

Ligji nr.121/2016 krijon vetëm kornizën ligjore për krijimin e Fondit Social, duke ia deleguar Këshillit të Ministrave (KM) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nxjerrjen e akteve nënligjore për ngritjen, funksionimin dhe administrimin e Fondit Social.

Bazuar në Nenin 47/4 të ligjit nr.121/2016, për ngritjen e Fondit Social, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.111/2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social” i cili parashikon se Fondi Social krijohet si një **mekanizëm financiar** nëpërmjet të cilit sigurohet **mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore**<sup>2</sup> për arritjen e qëllimeve të parashikuara në Nenin 47/1 të ligjit nr.121/2016. Megjithatë ajo që evidentohet nga kjo VKM dhe nga analiza e bërë në nivel të NJVQV objekt monitorimi është fakti se VKM nr.111/2018 rregullon krijimin e fondit social si një mekanizëm financiar në nivel të qeverisjes qendrore, nën administrimin e MSHMS, për financimin e shërbimeve sociale. Ndërkohë, mbetet e parregulluar ngritja dhe funksionimi i këtij mekanizmi në nivel të qeverisjes vendore. Edhe pse Neni 47/1 i ligjit nr.121/2016 parashikon se “Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social...”, në asnjë prej bashkive të analizuara nuk është ngritur ky mekanizëm në nivel vendor. Me qëllim rregullimin e kësaj problematike sugjerohet amendimi i VKM nr.111/2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social” me qëllim shtimin e dispozitave që rregullojnë krijimin e Fondit Social edhe në nivel Bashkie, ose miratimi i një VKM të posacme për ngritjen dhe funksionimin e fondit social në nivel Bashkie, sipas përcaktimit të ligjit.

Për sigurimin e mbështetjes financiare, VKM nr.111/2018 parashikon vlerësimin vjetor nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore të nevojave për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor **në përputhje me planin strategjik vendor** si edhe vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor.<sup>3</sup> Gjithashtu, VKM-ja parashikon se në planifikimin e shpenzimeve buxhetore Bashkitë duhet të kenë parasysh **vazhdimin e ofrimit të të paktën atyre shërbimeve që kanë ofruar në tri vitet e fundit.**<sup>4</sup> Nga ana tjetër, në nivel qendror, MSHMS duhet të parashikojë në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të cilat u transferohen njërive të vetëqeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime, **bazuar në planet sociale të buxhetuara.** Bazuar në këtë parashikim, shihet një lidhje e ngushtë dhe e kushtëzuar midis planeve sociale të miratuara në nivel vendor dhe fondit social, që do të thotë se vlerësimi i nevojave nga ana e bashkive dhe prioritetet në drejtim të ofrimit të shërbimeve shoqërore duhet të jenë të parashikuara dhe gjejnë reference në Planet Sociale të miratuara në nivel vendor.

Po kështu, VKM-ja nr.111/2019 rregullon edhe rastet kur Bashkitë nuk mund t'i ofrojnë vetë shërbimet e kujdesit shoqëror për të cilat kanë kërkuar mbështetje financiare përmes Fondit Social. Bazuar në Nenin 5.1 të VKM, shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të cilat konsiderohen si parësore nga bashkia, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, si ndërmarrje sociale apo

2 Vendim nr.111 datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, Neni 1.

3 Vendim nr.111 datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, Neni 4.

4 Vendim nr.111 datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, Neni 4.2.



struktura të ngjashme me to, që operojnë në këtë fushë private. Mënyra e bashkëpunimit midis NJVQV dhe organizatave bëhet në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Njësia e vetëqeverisjes vendore prokuron shërbimet e kujdesit shoqëror dhe lidh kontratat me ofruesit e shërbimit, duke u dhënë përparësi ndërmarrjeve sociale në ofrimin e këtyre shërbimeve.<sup>5</sup> Në një rast të tillë, NJVQV ngarkohen me monitorimin e ofrimit të shërbimeve nga ana e organizatave si edhe raportimit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror të financuar nga fondi social pranë Shërbimit Social Shtetëror. Për të përcaktuar sa më qartë rregullat e raportimit rekomandohet hartimi i një marrëveshjeje financimi midis MSHMS dhe Bashkive në rast të përfitimit nga Fondi Social. Në marrëveshje të tilla mund të parashikohen edhe rregullat mbi monitorimin dhe raportimin nga ana e Bashkive lidhur me shërbimet e ngritura/përmirësuara të financuara nga Fondi Social.

Nga analiza e mësipërme vlen të nënvizojmë se VKM nr.111/2016:

- a)** Parashikon krijimin e Fondit social si një mekanizëm financiar vetëm në nivel qendror për mbështetjen financiare të NJVQV
- b)** Fondi Social mund të ofrohet vetëm për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administrative të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, planifikimin e krijimit e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale.
- c)** Bashkitë duhet të vlerësojnë çdo vit nevojat për mbështetjen financiare nga Fondi Social
- ç)** Bashkitë duhet të paktën të planifikojnë vazhdimin e ofrimit të shërbimeve që kanë ofruar në tre vitet e fundit
- d)** Bashkitë mund të delegojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror tek OJF bazuar në rregullat e prokurimit të shërbimeve publike dhe lidhjes së kontratave të ofrimit të shërbimeve.

Problematikat kryesore të evidentuara që lidhen me këtë VKM lidhen me mungesën e dispozitave ligjore që rregullojnë ngritjen dhe funksionimin e Fondit Social në nivel Bashkie, me qëllim jo vetëm bërjen e tij funksional në të gjitha bashkitë, por edhe garantimin e koordinimit më të qëndrueshëm të këtij mekanizmi në nivel qendror dhe vendor. Gjithashtu, do të ishte i dobishëm rishikimi i drejtimeve për të cilat Bashkitë mund të përdorin Fondin Social dhe përqendrimin e tyre në drejtim të shërbimeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese.

<sup>5</sup> Vendim nr.111 datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", Neni 5.2

## 4. METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË FONDEVE PËR FINANÇIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR DHE HARTIMI I PLANEVE SOCIALE

Ligji nr.121/2016 i delegon Këshillit të Ministrave (KM) miratimin e metodologjisë së llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Për këtë arsye, KM miratoi në 2019, Vendimin nr. 150 datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror". Përveç metodologjisë së financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, Vkm nr.150/2019 detajon edhe procedurat për miratimin e planeve sociale në nivel vendor, të cilat do të shërbejnë si reference për përgatitjen e projekt propozimeve nga ana e Bashkive lidhur me kërkesat për financim përmes Fondit Social. Neni 4 i saj parashikon listën e të dhënave në kuadër të të cilave bazohet analiza dhe vlerësimi paraprak i nevojave që do të shërbejnë për hartimin e planit social nga NJVQV. Bazuar në këtë Nen, NJVQV duhet të hartojnë planet sociale bazuar në vlerësimin paraprak të të dhënave të poshtëlistuara:

- a) Të dhënat demografike bazë;
- b) Profilin dhe karakteristikat e kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
- c) Shërbimet ekzistuese në territorin e bashkisë ose në qarkun ku bën pjesë bashkia përkatëse;
- ç) Listën e shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre në territor;
- d) Financimin e shërbimeve aktuale;
- e) Të dhënat për strukturat që mbështesin apo ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror të ngritura në bashki dhe njësi administrative, në përputhje me ligjin;
- ë) Të dhëna krahasuese për buxhetin e bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij në territorin e bashkisë;
- f) Listën e shërbimeve shoqërore të munguara në territor.

Planet sociale miratohen për periudha tre vjeçare nga Këshilli i Bashkisë dhe përfshijnë shërbimet shoqërore ekzistuese dhe shërbimet e reja të kostuara, sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe burimet përkatëse të financimit të tyre. Për atë pjesë të planit social i cili mbetet i pambuluar nga buxheti i Bashkisë, Këshilli Bashkiak miraton, brenda muajit shkurt të çdo viti nevojat lidhur me kërkesat për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, bazuar në Vendimin nr.150/2019 Bashkitë hartojnë brenda tremujorit të parë të çdo viti kërkesat për financim nga Fondi Social të cilat iu dërgohen MSHMS së bashku me planet sociale vendore. Edhe pse kjo e parashikuar në ligj dhe vendimin nr.150/2019, praktika e ndjekur nga MSHMS deri tani ka qënë përmes Thirrjeve për aplikim drejtuar Bashkive të vendit. Në planin praktik, për shkak të vonësive në shpalljen e thirrjeve ose kërkesave të tjera të specifikuar përmes Thirrjeve, Bashkitë kanë gjetur vështirësi lidhur me aplikimin dhe përfitimin nga fondi social. Në këto kushte, ose VKM nr.150/2019 duhet të përfshijë këtë mënyrë aplikimi, ose mund të vazhdohet me procedurën sipas afateve të parashikuara në Vendimin nr.150.

Gjithashtu, përveç kriterit të parashikimit të nevojave në planet sociale vendore, VKM nr.150/2019 parashikon edhe listën e kriterëve mbi të cilat bazohet shpërndarja e fondeve buxhetore për financimin e Fondit Social në nivel vendor. Në mënyrë specifike këto kriterë lidhen me:

- a) kriterin e nevojës më të madhe;
- b) impaktin dhe prioritetet e çdo njësie të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve sipas planeve përkatëse sociale;
- c) mundësitë e financimit nga buxheti i shtetit;
- ç) shkallën e mbulimit të financimit të Fondit Social nga burime të tjera nga buxheti i shtetit;
- d) qëndrueshmërinë financiare të modelit të financimit të shërbimeve.

Mënyra se si janë formuluar kriteret, por edhe nga konsultimi në nivel bashkie vlen të nënvizohet se përmbajtja e tyre nuk është shumë e qartë për Bashkitë, duke e bërë të vështirë parashikueshmërinë nga ana e bashkive të nevojave për financim nga Fondi Social. Kështu, përshembull nëse marrim në konsideratë impaktin dhe prioritetet e çdo NJVQV, mund të rezultojë se kërkesat për financim të secilës prej NJVQV të konsiderohen si prioritare nga këto të fundit. Në këto kushte, për ta bërë më të qartë si edhe për të shmangur çdo klauzolë për interpretime subjektive, është e nevojshme përcaktimi i treguesve që do të masin secilin prej këtyre kriterëve. Një nevojë e tillë, vjen në dukje edhe për shkak se VKM 150/2019 përcakton një listë treguesish vetëm për kriterin e parë “nevoja më e madhe” duke parashikuar si pjesë të vlerësimit të saj:

- a) Numrin e popullsisë (10%);
- b) Shkallën e papunësisë (15%);
- c) Numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike (15%);
- ç) Numrin e personave me aftësi të kufizuar (20%);
- d) Numrin e kërkesave për strehim social (10%);
- e) Numrin e shërbimeve sociale të ofruara (10%);
- ë) Numrin e përfituesve të shërbimeve sociale të ofruara (10%);
- f) Numrin e organizatave që ofrojnë shërbime sociale (5%);
- g) Ofrimin e shërbimeve të reja sipas shportës së miratuar të shërbimeve (5%).

Megjithatë edhe në këtë rast, mënyra se si janë hartuar kriteret, duket sikur bashkitë më të mëdha janë ato të cilat mund të përfitojnë më shumë dhe më thjeshtë nga ky mekanizëm financimi. (psh. Nr I organizatave që ofrojnë shërbime sociale është më i lartë në Bashkitë e mëdha se sa të vogla). Gjithashtu, kriteret nuk janë të hartuara në të njëjtën logjikë: psh në rastin e ndihmës ekonomike VKM parashikon si kriter **numrin e përfituesve** dhe jo **numrin e kërkesave** për ndihmë ekonomike. Ndërkohë në rastin e strehimit social parashikohet e kundërta: **numri i kërkesave** dhe jo **numri i përfituesve** nga strehimi social.

Gjithashtu, mungojnë në VKM kriterë të cilat do t'i jepnin prioritet bashkive të cilat nuk kanë aplikuar apo përfituar nga Fondi Social asnjëherë, ose ato që kanë përfituar më pak. Një parashikim i tillë do të mundësonte një ndarje më të drejtë të fondit social në nivel vendor që do të mundësonte në të njëjtën kohë edhe një shtrirje më të gjerë të shërbimeve të kujdesit shoqëror në juridiksionin vendor.

Po kështu, me qëllim që financimi nga Fondi Social të jetë më transparent dhe më i qartë për bashkitë, nevojitet përcaktimi i kriterëve të qarta të aplikimit që lidhen edhe me llojin e projekteve që mund të financohet, prioritetet strategjike në fushën e kujdesit shoqëror, vlerën minimale dhe/ose maksimale të financimit për çdo vit, prioritetin e përfitimit të bashkive që aplikojnë për herë të parë, pajtueshmëria me planet sociale vendore etj. Detajimi dhe qartësimi i kriterëve të nevojshme për përfitimin nga fondi social bëhet akoma më i ndjeshëm për ato bashki që kanë kapacitete të kufizuara njerëzore brenda strukturave të shërbimit shoqëror.

Në të njëjtën kohë, VKM parashikon mundësinë e financimit të shërbimeve shoqërore nga organizatat e tjera vendase dhe të huaja, por nuk parashikon mundësinë e bashkëfinancimit midis tyre: pra projektet e përbashkëta që mund të mbulohen nga Fondi Social dhe donatorët duke ndarë shkallën e përqindjes së mbulimit të financimit midis të dyja subjekteve. Një mundësi e tillë mund të rriste numrin e shërbimeve të financuara duke zgjeruar edhe hartën e shtrirjes së tyre në të gjithë vendin.

Po kështu, me qëllim rritjen e numrit të bashkive që përfitojnë nga fondi social, mund të shihet si alternativë e mundshme edhe vendosja e kriterëve për përfitimin nga fondi social të bashkive që nuk kanë përfituar nga burime të tjera për të njëjtin shërbim të ofruar.

Në lidhje me mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, VKM 150/2019 përmban të njëjtat parashikime si edhe VKM nr.111/2018. Shërbimet e kujdesit shoqëror mund të ofrohen nga organizatat jo-fitimprurëse përmes lidhjes së kontratave të ofrimit të shërbimeve bazuar në procedurat e prokurimeve publike të ofrimit të shërbimeve.

VKM 150/2019 parashikon gjithashtu edhe mënyrën e financimit nga Fondi Social të kërkesave të ardhura në nivel qarku. Ajo që vihet re në këtë aspekt është fakti se ky nivel i qeverisjes vendore trajtohet në këtë akt, duke mos qenë më parë i parashikuar dhe rregulluar në ligjin nr.121/2016 apo VKM nr.111/2018. Për të shmangur problematikat që mund të vijnë në zbatim të VKM nr.150/2019 si edhe me qëllim që kjo VKM të jetë në përputhje me ligjin nr.121/2016 mund të sugjerohen ndërhyrjet e mëposhtme:

- a) Ligji nr.121/2016 mund të rishikohet në nenin 47/1 të tij me qëllim që “qarku” të përfshihet si nivel përfitues nga mekanizmi i fondit social. Në këtë kuptim sugjerohet që kjo dispozitë të parashikojë se “Bashkia/ Qarku, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale.”
- b) VKM nr.150/2019 mund të rishihet me qëllim që rregullat për financimin e Fondit Social të aplikohen vetëm në nivel Bashkie sipas parashikimeve të ligjit nr.121/2019.

Përzgjedhja e secilës prej ndërhyrjeve mund të bëhet në përputhje me qëllimin e qeverisë në kuadër të shtrirjes së këtij mekanizmi financiar.

Së fundi, rekomandohet që rishikimi i akteve të mësipërme ligjore, të konsiderojë edhe mundësinë e përfshirjes së rasteve ku përfitues nga fondi social të jenë edhe d yose më shumë bashki përmes projekteve të përbashkëta.

## 5. KUADRI LIGJOR LIDHUR ME PROKURIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Siç edhe e kemi analizuar, të dyja VKM nr.111/2018 dhe nr.150/2019 parashikojnë se Njësitë e vetëqeverisjes vendore prokurojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe lidhin kontratat me ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse. Për këtë qëllim, NJVQV hartojnë specifikimet teknike, bazuar në standardet e miratuara nga MSHMS për të organizuar dhe për të hapur tenderin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, kur ato ofrohen nga persona juridikë private. Rregullat e detajuara të prokurimit publik të shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 768 datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike , llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik si edhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”. Bazuar në këtë VKM, në kryerjen e procedurave të prokurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, NJVQV në cilësinë e autoriteteve kontraktuese duhet të veprojnë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës.

Një nga nenet që vlen për t’u analizuar në kuadër të problematikave të evidentuara nga NJVQV lidhur me prokurimin e shërbimeve sociale është Neni 3 “Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara”. Bazuar në këtë Nen, NJVQV në cilësinë e autoritetit kontraktues, mund t’i rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta të kujdesit shoqëror. Megjithatë, pavarësisht kësaj mundësie, pika 2 e Nenit 3 të VKM parashikon disa kriteret që duhet të plotësojë organizata për pjesëmarrjen në procedurat e sipërpërmendura. Në mënyrë specifike, në Nenin 3/2 shkronja ç) parashikohet se organizata **nuk duhet të jetë shpallur fituese e një kontrate të ofrimit të shërbimeve shoqërore gjatë tre viteve të fundit.**

Edhe pse qëllimi i ligjvënësist në këtë rast mund të ketë qenë i lidhur me ofrimin e mundësive për sa më shumë organizata dhe shmangien e kufizimit të ofrimit të shërbimeve vetëm nga disa OJF, në praktikë ky Nen ka sjellë vështirësi lidhur me vënien në përdorimin të Fondit Social nga ana e Bashkive, për shkak të numrit të vogël të OJF të specializuara në ofrimin e shërbimeve të caktuara. Bazuar në eksperiencën e bashkive, lidhja e kontratave të ofrimit të shërbimeve publike, përpara miratimit të vkm 768/2021, ka qenë më e thjeshtë dhe bashkitë nuk kushtëzoheshin nga kushti se OJF nuk duhet të ishin shpallur fituese gjatë tre viteve të fundit.

Një parashikim i tillë bëhet akoma më problematik për bashkitë e vogla, në të cilat numri i organizatave që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror në fusha të caktuara është i ulët ose i vetëm. Bazuar në këtë kufizim, bashki të ndryshme (përfshirë Tiranën) nuk kanë mundur të përfitojnë nga fondi social pas 2021 duke rrezikuar në këtë mënyrë edhe ofrimin e shërbimeve për kategoritë në nevojë apo ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror. Në të njëjtën kohë, një parashikimin i tillë mund të rrezikojë edhe cilësinë apo standardet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për shkak të pamundësisë së ofrimit të shërbimeve në kohë të gjatë nga organizata që janë të specializuara në një fushë të caktuar.

Në të njëjtën kohë, vlen të theksohet nevoja e shprehur pothuajse nga të gjitha bashkitë objekt vlerësimi, për asistimin lidhur me procedurat e prokurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Mungesa e burimeve njerëzore apo kapaciteteve në nivel të NJVQV lidhur me këtë proces, ka ndikuar në mosrealizimin me sukses të procedurave të prokurimit/ lidhjes së kontratave të financimit me pasojë mos-përdorimin e fondit social.

I vetmi përjashtim i përcaktuar në VKM lidhur me mungesën e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhet me rastin e shërbimeve, vlera e financimit të të cilave gjatë një viti financiar nuk i kalon 20.000.000 lekë. Në çdo rast tjetër, rregullat që duhet të zbatohen nga NJVQV janë ato të parashikuara shprehimisht në VKM nr.768/2021.

## 6. ANALIZË E PRAKTIKËS SË FUNKSIONIMIT TË FONDIT SOCIAL

Mekanizmi i financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ka sjellë rritjen e shërbimeve komunitare të ngritura sipas nevojave të vlerësuara të kategorive vulnerabël nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas planeve sociale vendore. Të dhënat nga MSHMS tregojnë se aktualisht ofrohen 493 shërbime sociale, krahasuar me 228 shërbime që ofroheshin në 2019. Nga këto 154 shërbime parashoqërore: 46 përqind e shërbimeve sigurohen nga institucione publike, ndërsa 42 përqind e tyre sigurohen nga institucione jo publike. Totali i përfituesve për vitin 2021 është 42,553, krahasuar me rreth 10.000 përfitues në 2019. Nga këta 22,553 në institucione publike, 11,509 në institucione jopublike dhe 8,511 në institucione të përziera.

Me anë të mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, gjatë periudhës 2020-2022 janë financuar 27 shërbime të reja në 26 Bashki, dhe 13 shërbime të specializuara në 6 Qarqe, me një vlerë prej 539 mln ALL, ku kanë përfituar shërbime 10,477 përfitues nga të gjitha kategoritë vulnerabël.

### Planet sociale vendore

Sikurse u përmend më sipër, VKM 150 kërkon që njësitë e qeverisjes vendore të kenë të miratuara planet sociale vendore si kusht për përfitimin e fondeve të mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Të dhënat nga bashkitë e kontaktuara gjatë përgatitjes së këtij raporti tregojnë se në fund të vitit 2022, rreth **85 përqind e bashkive e kanë patur të miratuar planin social** vendor që përfshin vitin 2022. Po kështu, 95 përqind e bashkive të kontaktuara, tregojnë se plani social vendor i miratuar **pasqyron në mënyrë të mirë nevojat** për shërbime të kujdesit shoqëror në bashki për periudhën kohore tre-vjeçare.


Arsyet kryesore që rreth 15 përqind e bashkive nuk e kanë patur të miratuar planin social vendor lidhen kryesisht me **mungesat e kapaciteteve** për përgatitjen e planit nga ana e bashkive (40 përqind e rasteve të kontaktuara) si dhe problematikat në **procedurën e miratimit** të planit social vendor (20 përqind e rasteve të kontaktuara).

Në mënyrë të vecantë përgatitja e planit social vendor është raportuar si proces i vështirë nga ana e **bashkive më të vogla**, për shkak të mungesës së strukturave administrative brenda tyre dhe problematikës specifike dhe të fragmentuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Nga ana tjetër, miratimi i planit social vendor nga Këshilli Bashkiak, në disa raste ka rezultuar problematik për shkak të **mungesës së buxhetimit të planit social vendor** në buxhetet e miratuara të bashkive, ndonëse sic u përmend më sipër, vetë miratimi i planit social vendor është kusht për përfitimin e fondeve të mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Kjo problematikë specifike kërkon një zgjidhje të qëndrueshme përmes rregullimeve ligjore.

Pothuaj 60 përqind e bashkive të kontaktuara treguan se **mungesa e kapaciteteve** në strukturat e tyre ishte problemi kryesor i ndeshur gjatë **përgatitjes** së planit social vendor. Gjithashtu, vështirësitë në **përlllogaritjen e kostove, dinamika në ndryshim** e nevojave për shërbime sociale dhe **vlerësimi** i tyre, si dhe **mungesa e udhëzimeve** të qarta mbi metodikën e përgatitjes së planit social vendor, ishin disa nga problemet e tjera të identifikuara në këtë proces.

## Tregoni problematikat kryesore me të cilat jeni ndeshur për përgatitjen e planit social

34 përgjigje



Aktet ligjore të cituara më sipër kërkojnë që përgatitja, miratimi dhe monitorimi i zbatimit të planit social vendor të kryhet në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror. **Mbi 50 përqind** e bashkive të kontaktuara raportuan se bashkëpunimi në këtë drejtim me drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ka qenë **efektiv dhe i dobishëm**. Ndërkohë, rreth 1/3 e bashkive raportuan se ky bashkëpunim ka qenë kryesisht formal, dhe në 9 përqind të rasteve gjatë përgatitjes si dhe në 18 përqind të rasteve gjatë monitorimit, ai ka munguar.

## Ngritja dhe funksionimi i Fondit Social

Neni 7 i Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, përcakton se fondi special i njësive të qeverisjes qendrore ose vendore krijohet me ligj të veçantë, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, me nismën e ministrit përgjegjës për financat.

Sipas përcaktimit të Nenit 47/1 të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, **Bashkia**, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, **krijon dhe administron fondin social**, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale.

Në kuptim të Nenit 47/1 të ligjit Nr.121/2016 **secila bashki duhet të krijojë dhe administrojë fondin social të saj si pjesë të programeve buxhetore nën administrimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**. Nga ana tjetër, VKM Nr. 111 datë 23.2.2018, në zbatim të këtij ligji, në pikën 1 përcakton “krijimin e fondit social të mekanizmit financiar, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Gjithashtu, Neni 47/2 i ligjit Nr.121/2016 parashikon si burime të financimit të Fondit Social si më poshtë:

- të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
- financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
- të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;



- c) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

Në kuadër të të dyja këtyre dispozitave, nën programin “Fondi Social” mund të krijohen si produkte buxhetore: përmirësimi i standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimi i shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale, realizimi i të cilave do të mbulohet nga burimet e parashikuara në Nenin 47/2 të ligjit Nr.121/2016.

Megjithatë, në VKM Nr. 111 datë 23.2.2018 dhe në VKM Nr. 150 datë 20.3.2019 që përcakton funksionimin e mekanizmit financiar për financimin e fondit social, apo në udhëzimet përkatëse, përfshirë ato të MFE për zbatimin e buxhetit vjetor (Udhëzimi Nr. 300/1 datë 10.1.2022 i MFE) mungojnë udhëzimet specifike për ngritjen dhe administrimin e fondit social, si një fond i vecantë në nivel bashkie.

Mungesa e udhëzimeve specifike për ngritjen dhe administrimin e fondit social në nivel bashkie ka rezultuar në perceptime dhe realitete të ndryshme mbi konceptin dhe funksionimin e fondit social në bashki të ndryshme. Nga monitorimi i kryer në nivel bashkie si pjesë e këtij studimi rezulton se në asnjërin prej bashkive **nuk është ngritur fondi social** sipas përcaktimit të Nenit 47/1 të ligjit Nr. 121/2016. Në asnjërin prej bashkive nuk ekziston një program i veçantë buxhetor si Fond Social përmes të cilit do të financoheshin produktet specifike buxhetore që lidheshin me përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale.


Në praktikë, bashkitë e kontaktuara raportuan se në mungesë të fondit social, si një fond i posaçëm buxhetor, financimi i ngritjes apo përmirësimit të shërbimeve të kujdesit social realizohet përmes fondeve të financimit të shërbimeve sociale sipas programeve buxhetore ekzistuese për shërbimet sociale (specifikisht programet “Kujdesi Social për familjen dhe fëmijët” apo “Kujdesi Social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar”). Edhe në terma të mekanizmit të fondit social në nivel qendror, financimi i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për produktet e planifikuara kalon përmes transfertave në këto programe buxhetore. Si rezultat, vlen të nënvizojmë se nisur nga fakti që financimi për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale **kryhet përmes programeve buxhetore** për financimin e shërbimeve sociale, ngelet me rëndësi ngritja e fondit social si mekanizëm financiar i posaçëm në nivel vendor konform parashikimit të Ligjit 121/2016 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

## Aspekte të programimit buxhetor

Financimi nga buxheti i shtetit konsiderohet si burimi kryesor për financimin e shërbimeve sociale nga pjesa më e madhe e bashkive, ndonëse aktet ligjore dhe nënligjore krijojnë hapësirën dhe inkurajojnë bashkitë që të kërkojnë dhe përdorin forma të tjera financimi. Kështu, mbi **40 përqind e bashkive** të kontaktuara treguan se kërkesa për financim nga buxheti i shtetit për shërbimet sociale përbën **mbi 50 përqind të nevojave për financim**.

**Lutemi tregoni sa është afërsisht përqindja e financimit të kërkuar nga buxheti i shtetit për fondin social te vitit 2022 në bashkinë tuaj?**


34 përgjigje



Nga ana tjetër, programimi i fondeve të veta për financimin e shërbimeve sociale nga pjesa më e madhe e bashkive është në nivel të ulët, **15 përqind e bashkive nuk kanë programuar fonde të tilla** dhe rreth 59 përqind e tyre kanë programuar fonde që plotësojnë deri në 50 përqind të nevojave.

**Lutemi tregoni sa është afërsisht financimi i programuar nga fondet e veta të bashkisë për fondin social te vitit 2022 në bashkinë tuaj?**


34 përgjigje



Programimi për financimin e shërbimeve sociale nga **donatorët dhe burime të tjera**, është raportuar në nivele edhe më të ulëta nga prej pjesa dërrmuese e bashkive. Rreth 53 përqind e bashkive treguan se nuk kanë programuar financime të tilla për vitin 2022.

### Lutemi tregoni sa është afërsisht financimi i programuar nga donatorë dhe burime të tjera për fondin social te vitit 2022 në bashkinë tuaj?

34 përgjigje



Mjetet financiare të vëna në dispozicion të bashkive për financimin e shërbimeve sociale janë përdorur kryesisht për **qëllimin e përcaktuar** dhe vetëm 15 përqind e bashkive të kontaktuar treguan se ka patur ndryshime destinacioni të financimit, ndërkohë që vetëm rreth 12 përqind e bashkive raportuan **mbartje të fondeve** në vitin pasardhës financiar.


## Financimi nga buxheti i shtetit

VKM Nr.150/2019 përcakton metodologjinë e llogaritjes së fondeve të financimit të shërbimeve sociale e të shpërndarjes së tyre nëpërmjet vendosjes së kriterëve e hapave që ndjek procesi. Sikurse u përmend në seksionin më sipër, financimi nga buxheti i shtetit për pjesën më të madhe të bashkive përbën burimin kryesor të fondit social.

Zbatimi i VKM Nr.150/2019 gjatë periudhës 2020-2022 ka mundësuar financimin e 27 shërbimeve të reja në 26 Bashki të vendit. Interesi për këtë burim financimi konfirmohet edhe nga të dhënat që tregojnë se thuhetse  $\frac{3}{4}$  e **bashkive të kontaktuar kanë paraqitur kërkesa për financim nga buxheti** i shtetit për fondin social. Mundësitë e kufizuara të buxhetit për financimin e kërkesave të bashkive kanë rezultuar në një numër më të vogël të bashkive përfituese, rreth **56 përqind e bashkive të kontaktuar kanë përfituar nga këto fonde**.


### A ka paraqitur ndonjëherë bashkia juaj kërkesë për financim nga buxheti i shtetit për fondin social?

34 përgjigje



### A ka bashkia juaj përfutuese e fondeve buxhetore për fondin social?


34 përgjigje



Së fundi vlen të theksohet se edhe për rastet kur bashkitë kanë qenë përfutuese të këtyre fondeve, financimi nga buxheti është vlerësuar nga 59 përqind të bashkive përfutuese të kontaktuara, si **i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat** për fondin social sipas planit social vendor.

### Në rast se po, a i kanë plotësuar këto fonde nevojat për financimin e fondit social, sipas planit social?


34 përgjigje



Mungesa e plotë ose e pjesshme e financimit nga buxheti i shtetit është kompensuar në plot raste të kontaktuara nga **financimi i buxhetit të vetë bashkisë** (të ardhurat lokale) ose përmes **kontributeve të OJF-ve dhe donatorëve** të ndryshëm.

## Vlerësime të përgjithshme


Pavarësisht problematikës së hasur në zbatimin e legjislacionit mbi fondin social, sikurse u përmend më sipër, ai përbën një **mekanizëm të dobishëm për financimin e shërbimeve sociale**. Rreth **41 përqind e bashkive** të kontaktuara e vlerësojnë fondin social si një **mekanizëm efektiv** për financimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu, **gjysma e bashkive** të kontaktuara shprehen se fondi social përbën një mekanizëm financiar që ndihmon financimin e shërbimeve sociale, por kërkon **përmirësime për të qenë më efektiv** në arritjen e objektivave. Vetëm rreth **9 përqind** e bashkive të kontaktuara raportojnë se fondi social paraqet **vështirësi për financimin** e shërbimeve sociale në nivel vendor.



Vlerësimet e marra nga bashkitë tregojnë se funksionimi i fondit social do të rezultonte më efektiv kryesisht duke ndryshuar kohëzgjatjen e financimit nga buxheti i shtetit, duke ndryshuar qasjen e financimit, duke ndryshuar kriteret e përzgjedhjes së bashkive përfituese apo duke përdorur një skemë të ndryshme financimi.

### Në vlerësimin tuaj, fondi social do të rezultonte më efektiv për financimin e shërbimeve sociale duke:

34 përgjigje



**Vështirësitë kryesore të raportuara nga bashkitë** e kontaktuar lidhen me: (i) kohëzgjatjen e kufizuar të financimit, (ii) problematikën me kapacitetet në dispozicion, përgatitjen e planit social dhe llogaritjen e kostove, (iii) financimin përmes thirrjeve dhe jo sipas planit social vendor të miratuar apo buxhetit vjetor, (iv) problematikës së prokurimeve të shërbimeve sociale, (v) sfazimin në kohë midis aplikimit dhe përfitimit të fondeve, (vi) nevojës në rritje për shërbime sociale, (vii) shmangia nga fryma e ligjit që thekson që financimi i Fondit Social të kryhet me transfertë në fillim të vitit, në modelin e Thirrjes për të aplikuar që nuk siguron financimin qëndrueshmërinë e shërbimeve social në territor, (viii) vështirësitë e hasura në përgatitjen e projekteve për aplikim etj.

Gjithashtu bashkitë kanë treguar se është e nevojshme jo vetëm që të ketë **udhëzime të qarta** për ngritjen dhe administrimin e fondit social, por njëkohësisht si një praktikë relativisht e re, të organizohen edhe **sesione trajnuese për zyrat e buxhetit, financës dhe shërbimeve sociale** të të gjitha bashkive, për të mundësuar një **kuptim të njëjtë të procedurave** standarte për zbatimin e buxhetit për shërbimet sociale **në të gjitha bashkitë** e vendit.

Diskutimet me bashkitë rreth fondit social treguan se ato janë të interesuara që financimi të shtrihet në një **afat më të gjatë kohor**, që përqindja e mbuluar nga Ministria të mos jetë e njëjtë për të gjitha bashkitë por në **varësi të të ardhurave** të saj, të mbështeten edhe me **pajisje dhe me infrastrukturë** të nevojshme sic është rasti për personat me A.K, që **prokurimi i shërbimeve** sociale të realizohet me një procedurë të posacme, të ndihmohen bashkitë në forcimin e **kapaciteteve**, që përqindja e **financimit nga buxheti të vijë në rritje** për shkak të nevojave në rritje për shërbime sociale, që fondi social të jetë **efektiv që nga 1 janari** i cdo viti, që të ketë një **shpërndarje më të drejtë të fondeve sociale** sipas bashkive pasi **bashkitë e vogla kanë mundësi më të vogla financimi dhe ndihmese në trajnimin për përgatitjen e projekteve.**

## 7. REKOMANDIME LIDHUR ME ANALIZËN LIGJORE DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL

Bazuar në analizën e kuadrit ligjor dhe praktikës së ngritjes dhe funksionimit të Fondit Social, rekomandohet:

- Rishikimi i bazës ligjore që lidhet me Fondin Social për të mundësuar ngritjen e tij nga cdo bashki sipas kuptimit të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë qëllim sugjerohet rishikimi i VKM nr.111/2018 me qëllim që të parashikohet ngritja dhe funksionimi i fondit social jo vetëm në nivel qendror, por edhe në nivel bashkie.
- Rishikimi i VKM nr.150/2019 lidhur me përfshirjen e Qarkut si nivel që mund të aplikojë dhe përfitojë me të njëjtat kritere nga Fondi Social si edhe Bashkitë, sikurse dhe aplikimet e përbashkëta nga dy ose më shumë bashki. Duke qënë se ky nivel nuk është i përfshirë në ligjin nr.121/2019 sugjerohet ose rishikimi i ligjit me qëllim shtimin e krijimit të mekanizmit të fondit social në nivel qarku, ose rishikimi i VKM nr.150/2019 me qëllim përcaktimin e metodologjisë vetëm në nivel Bashkie.
- Zbatimin e parashikimeve ligjore lidhur me rrugën dhe procedurat që ndjekin Bashkitë për të përfituar financim në Fondin Social dhe shmangien e praktikës së financimit përmes thirrjeve. Rekomandohet që aplikimi në vitet në vazhdim të mund të bëhet sipas kërkesave të dërguara nga Bashkitë brenda tremujorit të parë të vitit në përputhje me aktet ligjore në fuqi për buxhetin e shtetit.
- Për zbatimin e akteve të mësipërme ligjore rekomandohet përgatitja e një Udhëzuesi nga MSHMS (në bashkëpunim me MFE) për mënyrën dhe hapat që duhet të ndjekin NJVQV me qëllim përfitimin nga mekanizmi i financimit përmes Fondit Social.
- Sugjerohet që në drejtim të kritereve të financimit të parashikohet edhe vendosja e kritereve të cilat do t’i jepnin prioritet bashkive të cilat nuk kanë aplikuar apo përfituar nga Fondi Social asnjëherë, ose ato që kanë përfituar më pak si edhe vendosja e « numrit të përfituesve nga shërbimet » si kriter.
- Me qëllim që financimi nga Fondi Social të jetë më transparent dhe më i qartë për bashkitë, udhëzuesi mund të përmbajë kritere që lidhen edhe me llojin e projekteve që mund të financohet, prioritetet strategjike në fushën e kujdesit shoqëror, vlerën minimale dhe/ose maksimale të financimit për çdo vit, tavanet e financimit, prioritetin e përfitimit të bashkive që aplikojnë për herë të parë.
- Me qëllim rritjen e transparencës, sugjerohet publikimi në faqen zyrtare të Ministrisë edhe i Bashkive/projekteve që janë financuar çdo vit nga Fondi Social.
- Nevojitet një parashikim më i qartë lidhur me koherencën dhe lidhjen që duhet të ekzistojë midis Planeve Sociale Vendore dhe kërkesave për financim nga Fondi Social.

- Rekomandohet parashikimi në VKM nr.150/2019 i mundësisë së bashkëfinancimit të projekteve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga Fondi Social dhe organizatat vendase apo ndërkombëtare përmes projekteve të përbashkëta si edhe i mundësisë së financimit të projekteve të përbashkëta midis 2 apo më shumë bashkive.
- Rekomandohet rishikimi i VKM 768/2021 lidhur me kufizimin e afatit të përfitimit të organizatave nëse ato kanë qënë fituese në tre vitet e fundit.
- Në terma të monitorimit dhe raportimit, rekomandohet parashikimi në VKM nr.150/2019 i detyrimit për të lidhur një marrëveshjeje financimi midis MSHMS dhe Bashkive në rast të përfitimit nga Fondi Social. Në këtë marrëveshje do të parashikohen edhe rregullat mbi monitorimin dhe raportimin nga ana e Bashkive lidhur me shërbimet e ngritura/përmirësuara të financuara nga Fondi Social.



